# DËSHMI ARKIVI

**A-464027**

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

VERSIONI 2

> **Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Del fotoja e 'bosit' shqiptar i arrestuar në Rusi, furnizonte me kokainë kartelet e drogës. Bisedat për 20 milionë euro cash |
| ADRESA | `https://piranjat.al/aktualitet/del-fotoja-e-bosit-shqiptar-i-arrestuar-ne-rusi-furnizonte-me-kokaine-i105707` |
| BURIMI | piranjat.al |
| GJENDJA | edited |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 23 shtator 2026, 19:16:39 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 23 shtator 2026, 19:00:34 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `e0bbc7e43187b8201fccbeef21d8c2864d41cfac116c26ee12a1be0e695e0f0e` |
| TEKSTI | `c94bc76855ba2c2cd0e8c5c9320c1867857af3ede75236ef090c080bb6be2732` |
| PAMJA | `ff27af04bb27242f1097d0a08fe474885fa65e02bcb0b98515036cff734a5ace` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `f1ccbd1a49fbab13b794991fe8cc4b6e80b64c4dd3120e750d11db5b6c834c16` |
| E MËPARSHMJA | `ea763ddd0ca07e2135e920d298f620bf8a33afd126a301654467248d08b178eb` |
| RRËNJA MERKLE | `55f810520a93a3fb0649992dafdc0630325acd6490d1af12697ee3ba7602edf3` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/f1ccbd1a49fbab13b794991fe8cc4b6e80b64c4dd3120e750d11db5b6c834c16`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

AKTUALITET

# Del fotoja e 'bosit' shqiptar i arrestuar në Rusi, furnizonte me kokainë kartelet e drogës. Bisedat për 20 milionë euro cash

Piranjat Përditësimi i fundit 23 Shtator 2026, 21:00



Është arrestuar në Rusi, me qëllim ekstradimi, Shpëtim Aliu, i njohur edhe me emrin Salvatore, i shpallur në kërkim nga SPAK si drejtues i një grupi kriminal që dyshohet se ka trafikuar dhjetëra tonë kokainë.

Autoritetet shqiptare janë vënë në dijeni të ndalimit të Aliut dhe pritet nisja e procedurave nga Ministria e Drejtësisë për ekstradimin e tij.

Shpëtim Aliu, i njohur edhe me emrin Salvadore, dyshohet nga hetimet se ka pasur rol të rëndësishëm në trafikun e kokainës dhe në qarkullimin e të ardhurave të përfituara nga aktiviteti kriminal.

Sipas dosjes hetimore, Aliu dyshohet se ka qenë furnizues i grupeve kriminale të drejtuara nga Eldi Dizdari, Dritan Gjika dhe Armando Pacani. Krahas aktivitetit të trafikut të drogës, ai dyshohet se ka investuar dhe pastruar në Shqipëri të ardhura kriminale përmes bizneseve në sektorin e ndërtimit dhe pasurive të paluajtshme.

Hetuesit dyshojnë se shuma e parave të pastruara arrin në të paktën 30 milionë euro. Në këtë aktivitet dyshohet se është përfshirë edhe vëllai i tij, Isa Aliu, i cili, sipas hetimeve, kishte rol në administrimin dhe investimin e parave.

Të dhënat e zbardhura nga komunikimet në platformën SKY ECC përfshijnë biseda mes dy vëllezërve gjatë gushtit 2020, ku diskutohen shuma të konsiderueshme parash të siguruara nga aktiviteti kriminal.

Në një prej komunikimeve, Isa Aliu përmend se kishte në dispozicion rreth 6 milionë euro cash. Në biseda të tjera flitet edhe për rreth 20 milionë euro të tjera, të cilat pritej të siguroheshin dhe të investoheshin.

Sipas dyshimeve të hetimit, ndërsa Shpëtim Aliu merrej me furnizimin dhe trafikun e kokainës, vëllai i tij Isa Aliu ishte angazhuar në menaxhimin dhe pastrimin e parave të përfituara nga aktiviteti kriminal.





## Artikuj te sugjeruar

AKTUALITET 23 Shtator20:47

**[“Tabela e rezultateve”, loja e rrezikshme që po përhapet në rrjete sociale mes të rinjve]**

Një “lojë” e rrezikshme po qarkullon në rrjetet sociale mes të rinjve në Britani, ku incidentet e dhunshme kthehen në...

AKTUALITET 23 Shtator20:41

**[EMRI/ U dënua me 15 vite burg nga GJKKO, 47-vjeçari arrestohet në Itali. Këto janë krimet që rëndojnë mbi të]**

Një 47-vjeçar është arrestuar në Itali, pasi ishte shpallur në kërkim ndërkombëtar nga autoritetet shqiptare. Alo...

AKTUALITET 23 Shtator20:30

**[Mbushi me drogë Europën/ Kush është Shpëtim Aliu, bashkëpunëtor me tre grupet më të fuqishme shqiptare të trafikut të kokainës]**

Salvadore alias Shpëtim Aliu është personi kyç i aksionit të qershorit të SPAK ndaj grupeve kriminale të trafikimit të...

AKTUALITET 23 Shtator20:29

**[EMRI/ Furnizonte me kokainë grupet shqiptare të trafikut të drogës, kush është bosi shqiptar i arrestuar në Rusi]**

Salvatore alias Shpëtim Aliu, një prej personave më të kërkuar nga drejtësia shqiptare dhe i konsideruar nga SPAK si një prej...

AKTUALITET 23 Shtator20:12

**[“Po na digjet Shqipëria, reagoni!”/ Profesori Lush Susaj apel qytetarëve: Bashkohuni me ne]**

Profesori Lush Susaj u bëri thirrje qytetarëve që t’i bashkohen protestës kundër qeverisë dhe të dalin në “s...

AKTUALITET 23 Shtator20:09

**[“SPAK ka nisur hetimet", aktivistja në protestën e 116-të: Rrjolli ka shënuar një fitore të madhe sot]**

Aktivistja Luçiana Kokaj, gjatë protestës së 116-të kundër qeverisë, deklaroi se nisja e hetimeve nga SPAK për ç...

AKTUALITET 23 Shtator19:35

**[Të dielën ‘Tiranathlon’/ Ja rrugët ku do të kufizohet qarkullimi dhe linjat urbane qe do devijojnë]**

Tirana do të presë “Triathlon”, sporti që bashkon tre disiplinat sportive më të njohura dhe të praktikuara në nj&...

AKTUALITET 23 Shtator19:22

[EMRI/ I maskuar, i riu shqiptar shpërndante dy lloje droge! Grupi në WhatsApp i "shtoi telashet"]

Një shpërndarës droge i maskuar si korrier i kompanisë "Just Eat" u kap nga policia teksa shpërndante lëndë narko...

AKTUALITET 23 Shtator19:12

[16 vite nga zhdukja misterioze/ SPAK: Nuk rezulton të ketë çështje të regjistruar për Bleona Matën]

Prej disa ditësh është rikthyer në vëmendje çështja e Bleona Matës, e cila prej 16 vitesh rezulton e zhdukur. Sot n&eu...

AKTUALITET 23 Shtator19:12

[Priste trenin me të dashurën, i arratisuri nga Shqipëria prangoset në stacion]

Një burrë shqiptar, ndaj të cilit ishte lëshuar një urdhër arresti ndërkombëtar, po priste me qetësi një tren ...

## ME TE VIZITUARAT

AKTUALITET 23 Shtator

[Skandal/ Kreu i SHISH mesazh Agasit: Zemër, duh...]

Më 18 shtator, Vlora Hyseni është marrë në pyetje nga agjentët e Byrosë Kombëtare të Hetimit si person në di...

POLITIKE 22 Shtator

["Balluku kur do arrestohet?" - Gazetari Qyno: K...]

Gazetari Elton Qyno ka debatuar mbrëmjen e sotme me juristët në emisionin "Top Story", lidhur me hetimet e SPAK ndaj ish-zëvend&...

AKTUALITET 22 Shtator

["Pinte kafe çdo javë me Dumanin"/ Urdhër-arrest...]

Gazetari Elton Qyno ka komentuar mbrëmjen e sotme në 'Top Story' urdhër-arrestin e SPAK për kreun e SHISH, Vlora Hyseni. Qyno k...

Nga Xhuljan Ferzaj INVESTIGIME 23 Shtator11:40

[EKSKLUZIVE/ Eskortat e huaja "mbysin" Tiranën: Si vajzat nga Brazili, Kolumbia e Vietnami ofrojnë shërbime sek*uale për 50-150 euro]

Prostitucioni me shtetase të huaja po shfaqet gjithnjë e më hapur në disa prej qyteteve kryesore të Shqipërisë. Përmes...

## video



### PIRANJAT SHOW - SEZONI 10 EPISODI 1



#### PIRANJAT SHOW - SEZONI 10 EPISODI 1






**“Dua 120 mijë euro”/ Si u zaptua prona në rrugën e Durrësit, zbardhet skema e mashtrimit**




Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.